



REPUBLICA E KOSOVËS
REPUBLICA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC



KUVENDI KOMUNAL OBILIQ
Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, të mbajtur me dt.22.05.2026, në ora 11:00, në sallën e Kuvendit komunal.

Të pranishëm ishin: Sami Ahmeti, Fjolla Nasufi, Albanë Shillova Shalaku, Vlora Mjekiqi Kabashi, Labinot Mirena, Abdyrrahman Krasniqi dhe Dorentina Krasniqi

Të pranishëm të tjerë: drejtorët komunal, përf. e OSBE-së dhe përf. e KFOR-it

Mbledhjen e udhëhoqi Sami Ahmeti, kryesues i cili pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

REND DITE

1. Arsyetimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF-së (24.04.2026)
3. Shqyrtimi i kërkesës së Kryetarit të Komunës për plotësim-ndryshimin e vendimit të formimit të KKS-së, me nr.02-020-01-13244-26 të dt.13.05.2026
4. Shqyrtimi i kërkesës së Kryetarit të Komunës me nr.01-020-01-13241-26 të dt.13.05.2026 për shqyrtimin e raportit të Komisionit për vlerësimin e dëmeve gjatë vërshimeve të fundit
5. Shqyrtimi i kërkesës së Fuad Hashanit me nr.01-070/05-0011327/26 të dt.24.04.2026 për përmbushjen e obligimeve financiare ndaj Kryetarëve të Këshillave të Fshatrave
6. Të ndryshme

Kryesuesi – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës dhe propozoi që në pikën 5 të jetë shqyrtimi i kërkesës së Kryetarit të Komunës për subvencionimin e NPL “Kastrioti”.

Miratohet rendi i ditës me 7 vota për me ndryshimin e cekur më lartë.

Pika 1 e rendit të ditës

Të gjithë anëtarët ishin të pranishëm.

Pika 2 e rendit të ditës

Miratohet ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar me 7 vota për.

Pika 3 e rendit të ditës

Kryesuesi- Paraqiti shqyrtimin e kërkesës së Kryetarit të Komunës për plotësim-ndryshimin e vendimit të formimit të KKS-së, me nr.02-020-01-13244-26 të dt.13.05.2026. Herën e kaluar është propozuar znj.Ivana Spasic, anëtare e KKS-së, e cila është punëtore e z.Slavisa Adjancicit dhe ata gjatë bisedimeve kanë bërë kërkesë se më mirë është me qenë udhëheqësi i Zyres për komunitete dhe kthim, kështu që znj.Ivana Spasic është tërheqë prej KKS-së.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit Komunal shqyrtimin dhe aprovimin e kërkesës së Kryetarit të Komunës nr.02-020-01-13244-26 të dt.13.05.2026.për plotësim-ndryshimin e vendimit të formimit të KKS-së.

Pika 4 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqiti shqyrtimin e kërkesës së Kryetarit të Komunës me nr.01-020-01-13241-26 të dt.13.05.2026 për shqyrtimin e raportit të Komisionit për vlerësimin e dëmeve gjatë vërshimeve të fundit. Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit Komunal shqyrtimin dhe aprovimin e kërkesës së Kryetarit të Komunës me nr.02-020-01-13241-26 të dt.13.05.2026 për shqyrtimin e raportit të Komisionit për vlerësimin e dëmeve gjatë vërshimeve të fundit.

Pika 5 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqiti kërkesën nga z.Flakron Mjekiqi, UD i Kryeshefit Ekzekutiv, që DSHPE-ja, të bëjë subvencionimin e NPL "Kastrioti" në 2 fusha. Sigurisht jeni në dijeni se ne i kemi kaluar të gjitha procedurat e formimit të Departamentit për mbledhjen e mbeturinave në kuadër të NPL "Kastrioti". Tashmë jemi në procedurat finale dhe besojmë se prej 1 qershorit ndërmarrja në fjalë do të filloj me mbledhjen e mbeturinave familjare, që deri më tani kemi pasë probleme të shumta. Po ashtu, do të shtohen makineri në kuadër të NPL-së, garazhda që do të merret me mirëmbajtjen e automjeteve dhe në këto 2 fusha kanë bërë kërkesë për subvencionim në vlerën prej 60.000 euro. Propozoj ti rekomandojmë Kuvendit dhe atje mund të debatojmë.

Abdyrrahman Krasniqi – Kryesues, ndoshta kishte me qenë mirë me shikue aspektin ligjor se a kemi të drejtë ne me subvencionue prej investimeve kapitale dhe unë e di se më heret i kemi subvencionue për pajisje për ofrimin e shërbimeve. Do të thotë për mos me pasë ndonjë kthesë për shembull prej Ministrisë, mos me shkelë ligjin në këtë aspekt me shikue përndryshe është në rregullë.

Kryesuesi – Sigurisht se kërkesa është bërë shpejtë dhe nuk e garantoj që mundemi me pasë edhe ndonjë telashe, por do të provojmë para se të bëhet miratimi me i marrë të gjitha mundësitë që të paktën kur të nxjerret një vendim edhe me na ardhë i ligjshëm.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit Komunal shqyrtimin dhe aprovimin e kërkesës së Kryetarit të Komunës me nr.02-104/02-14228/26 e dt.21.05.2026 për subvencionimin e NPL "Kastrioti" SH.A.

Pika 6 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqiti shqyrtimin e kërkesës nga Fuad Hashani me nr.01-070/05-0011327/26 të dt.24.04.2026 për përmbushjen e obligimeve financiare për Kryetarët e Këshillave të Fshatrave.Unë kam marrë pjesë në javën e kaluar në mbledhjen e kolegjiut të kryesuesve të Kuvendeve Komunale, në kuadër të Asociacionit të Komunave të Kosovës dhe të gjithë e kishin këtë problem. Mjetet duhet të jenë të parapara prej mallrave dhe shërbimeve për përmbushjen e këtyre obligimeve.

Abdyrrahman Krasniqi - Nëse, e shohim në aspektin politik kjo besoj se më shumë është punë vullnetare dhe ne nuk po flasim për trupat e Kuvendit, që i kemi përzgjedhë këtu por po flasim për Kryetarët e Këshillave të Fshatrave, që i kemi dhe ata absolutisht nuk kanë kurgjë të bëjnë me Kuvendin. Ne nuk kemi me nxjerrë vendim fare këtu, përndryshe vendimi na kthehet sepse kjo është çështje e Ekzekutivit.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për ia rekomanduan DEFZH-së shqyrtimin e kërkesës nga Fuad Hashani për përmbushjen e obligimeve financiare ndaj Kryetarëve të Këshillave të Fshatrave.

Pika 7 e rendit të ditës

Kryesuesi – Meqë, nuk kemi asgjë në pikën të ndryshme, atëherë edhe e mbylli seancën.

Mbledhja përfundoi në ora 11.19'

Zyrtare e lartë për punë të KK

Azize Zeneli



Kryesues i Komitetit

Samir Ahmeti